




Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosovo
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva



KUVENDI I KOMUNËS

RREGULLORE PËR ORARIN E PUNËS PËR BIZNESET QË OPEROJNË NË TERRITORIN E KOMUNËS SË PODUJEVËS

Podujevë, 29 shtator 2022

Në bazë të neneve 11, 12.1 dhe 12.2 shkronja c) të Ligjit për vetëqeverisjen lokale, nr.03/L-040, nenin 40 të Ligjit nr.2004/18 për tregtinë e brendshme, Ligjin nr.04/L-005 për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit nr.2004/18 për tregtinë brendshme, nenet 14, 15 paragrafët 1 dhe 2.3, të Statutit të Komunës së Podujevës nr.prot.01-020/01-0050862/18, Kuvendi i Komunës së Podujevës, në propozim të Drejtorisë së Planifikimit dhe Zhvillimit Ekonomik dhe në mbledhjen e mbajtur më 29 shtator 2022, miratoi këtë,

RREGULLORE PËR ORARIN E PUNËS PËR BIZNESET QË OPEROJNË NË TERRITORIN E KOMUNËS SË PODUJEVËS

I. DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Qëllimi

Neni 1

Me këtë Rregullore përcaktohet fillimi dhe mbarimi i orarit të punës për Bizneset që operojnë në territorin e Komunës së Podujevës.

Neni 2

Bizneset, në pajtim me nenin 1 të kësaj Rregulloreje, janë të obliguara t'i përmbahen orarit të punës të përcaktuar me këtë Rregullore.

Neni 3

1. Orari i punës nënkupton periudhën kohore fillimin dhe mbarimin e punës.
2. Orari për fillimin dhe mbarimin e punës, i përcaktuar me këtë Rregullore, duhet të vendoset në hyrje apo në vend të dukshëm të objektit në të cilin kryhet veprimtaria e biznesit.

Përkufizimet

Neni 4

Shprehjet e përdorura në këtë rregullore kanë kuptimin si vijon:

- 1.1. Periudha verore nënkupton periudhën prej **01.04 - 31.10** të vitit kalendarik.
- 1.2. Periudha dimërore nënkupton periudhën prej **01.11 - 31.03** të vitit kalendarik.
- 1.3. Festë zyrtare, ditë jo pune sipas kësaj Rregulloreje, nënkupton **01 janar-Viti i Ri, 17 Shkurti, Bajrami i Madh, Bajrami i Vogël.**

II. ORARI I PUNËS I BIZNESEVE

Neni 5

1. Floktarët, rrojtoret, sallonet e zbukurimit për meshkuj dhe veprimtarit tjera të përafërta:
 - 1.1. Periudha verore, prej orës **8:00 – 21:00**
 - 1.2. Periudha dimërore, prej orës **8:00 – 19:00**
 - 1.3. Festave zyrtare - sipas paragrafit 1.3 të nenit 4, nuk punohet.

2. Dyqanet e qepjes, këpucëtarët, artarët, orëndreqësit dhe veprimtarit tjera të përafërta:
 - 2.1. Periudha verore, prej orës **8:00 – 20:00;**
 - 2.2. Periudha dimërore prej orës **8:00 - 19:00.**
 - 2.3. Festave zyrtare - sipas paragrafit 1.3 të nenit 4, nuk punohet.

3. Sallonet e zbukurimit për femra dhe veprimtaritë tjera të përafërta:
 - 3.1. Periudha verore prej orës **8:00 - 21:00;**
 - 3.2. Periudha dimërore prej orës **8:00 - 19:00;**
 - 3.3. Në periudhën **01.06** deri më **31.08** mundë të punojnë nga ora **5:00-21:00**
 - 3.4. Festave zyrtare - sipas paragrafit 1.3 të nenit 4, nuk punohet.

4. Auto serviset, serviset e mjeteve tjera motorike dhe zejet e tjera të përafërta:
 - 4.1. Periudha verore, prej orës **8:00 – 20:00;**
 - 4.2. Periudha dimërore prej orës **8:00 – 19:00;**
 - 4.3. Në raste specifike mund të punohet më gjatë me kusht që lokali duhet të jetë i mbyllur.
 - 4.4. Festave zyrtare - sipas paragrafit 1.3 të nenit 4, nuk punohet.

5. Auto-larjet, larja e orendive shtëpiake, larja e lokaleve dhe zyrave dhe veprimtaritë tjera të përafërta:
 - 5.1. Periudha verore, prej orës **8:00- 20:00;**
 - 5.2. Periudha dimërore, prej orës **8:00 -19:00;**
 - 5.3. Festave zyrtare - sipas paragrafit 1.3 të nenit 4, nuk punohet.

6. Rent a car, marrjen/dhënien me qira të automjeteve/veturave (lizing):
 - 6.1. Periudha verore, prej orës **8:00 -24:00;**
 - 6.2. Periudha dimërore, prej orës **8:00 – 22:00;**

Neni 6

- 1. Qendrat tregtare, supermarketet, marketet dhe dyqanet e vogla ushqimore:**
 - 1.1. Periudha verore, prej orës 7:00 – 23:00;**
 - 1.2. Periudha dimërore, prej orës 7:00 – 22:00;**

- 2. Dyqanet e tekstilit, këpucëve, pajisjeve teknike shtëpiake dhe veprimtaritë tjera të përafërta:**
 - 2.1. Periudha verore, prej orës 8:00 – 22:00;**
 - 2.2. Periudha dimërore, prej orës 8:00 – 20:00;**

- 3. Dyqanet e kozmetikës, bizhuterive, dekorimeve dhe veprimtarit tjera të përafërta:**
 - 3.1. Periudha verore, prej orës 8:00 – 22:00;**
 - 3.2. Periudha dimërore, prej orës 8:00 – 20:00;**

- 4. Dyqanet tregtare të pajisjeve sanitare, të rrymës, ndërtimore dhe veprimtarit tjera të përafërta:**
 - 4.1. Periudha verore, prej orës 7:00-22:00;**
 - 4.2. Periudha dimërore, prej orës 8:00-20:00;**

- 5. Barnatoret bujqësore, dyqanet e pemëve dhe perimeve me pakicë, mishtoret dhe veprimtarit tjera të përafërta:**
 - 5.1. Periudha verore, prej orës 7:00- 22:00;**
 - 5.2. Periudha dimërore, prej orës 7:00-20:00;**

- 6. Festave zyrtare - sipas paragrafit 1.3 të nenit 4, nuk punohet.**

Neni 7

- 1. Veprimtaria ndërtimore (ndërtimi i ulët dhe i lartë):**
 - 1.1. Periudha verore, prej orës 7:00 - 18:00;**
 - 1.2. Periudha dimërore, prej orës 8:00 - 17:00;**
 - 1.3. Festave zyrtare - sipas paragrafit 1.3 të nenit 4, nuk punohet.**

- 2. Bizneset ndërtimore, në raste të jashtëzakonshme, për shkak të natyrës së punëve dhe interesit publik, me leje të posaçme, të cilën e lëshon Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit Ekonomik, mund të punojnë me orar të zgjatur deri në orën 23:00.**

Neni 8

1. Gastronomia:

- 1.1. Periudha verore, prej orës : **06:00-24:00**
- 1.2. Periudha dimërore, prej orës: **07:00-23:00**

2. Hotelet, Motelet:

- 2.1. Periudha verore, prej orës: **00:00-24:00**
- 2.2. Periudha dimërore, prej orës: **00:00-24:00**
- 2.3. Pas orës 24:00 nuk lejohet shërbimi në hapësirat e jashtme të objektit.

3. Internet - kafe, video lojëra, bilardot dhe veprimtarit tjera të përafërta.

- 3.1. Periudha verore, prej orë **8:00-24:00;**
- 3.2. Periudha dimërore, prej orës **8:00-23:00;**

4. Gastronomia/shërbimi merr me vete dhe porosi me dërgesë:

- 4.1. Gjatë gjithë vitit, prej orës **00:00-24:00;**

5. Veprimtarive nga paragrafi 1, 2, 3 dhe 4 të këtij neni gjatë orarit të punës nuk u lejohet tu prishin qetësinë qytetarëve që banojnë në afërsi të lokaleve ku ushtrohet veprimtaria.

6. Në objektet hoteliere të cilat gjenden në afërsi deri 100m nga objektet e banimit, në të cilat organizohet program me muzikë të gjallë apo me audio-video mjete për riprodhimin e programit, programi nuk mundë të vazhdojë pas orës 24:00.

7. Bizneset janë të obliguara të ushtrojnë veprimtarinë e tyre në pajtim me Ligjin për Rendin dhe Qetësin Publike si dhe Ligjin për Mbrojtje nga Zhurma.

Neni 9

1. Orari i punës për gjellëtoret;

- 1.1. Periudha verore, prej orës **07:00-21:00;**
- 1.2. Periudha dimërore, prej orës **07:00-20:00**
- 1.3. Festave zyrtare - sipas paragrafit 1.3 të nenit 4, nuk punohet.

Neni 10

1. Stadiumet e futbollit dhe palestrat sportive, fitneset dhe të ngjashme: punojnë prej orës: **08:00-24:00;**

2. Pishinat e hapura, punojë gjatë periudhës verore prej orës **8:00 - 24:00;**

3. Pishinat e mbyllura punojnë gjatë gjithë vitit prej **8:00 - 24:00;**

Neni 11

1. Orari i punës për tregjet e qytetit dhe tregjet e lokaliteteve është:
 - 1.1. Periudha verore, prej orës **7:00 – 20:00**;
 - 1.2. Periudha dimërore, prej orës **7:00 – 18:00**;
2. Tregu i gjelbër nuk do të punojë të dielave dhe ditëve të festave zyrtare.
3. Tregu i kafshëve punon të shtunave me orar sipas nevojës.

Neni 12

1. Pikat e shitjes së karburanteve :
 - 1.1. Gjatë gjithë vitit, **00:00-24:00**;
 - 1.2. Ky orar vlen vetëm për shitjen e karburanteve kurse aktivitetet tjera brenda hapësirave të biznesit operojnë sipas orarit të përcaktuar me këtë Rregullore.

Neni 13

1. Furrat e bukës.
 - 1.1. Periudha verore, prej orës: **05:00- 24:00**;
 - 1.2. Periudha dimërore, prej orës: **06:00-24:00**;
 - 1.3. Gjatë muajit të Ramazanit punojnë deri në syfyr.

Neni 14

1. Veprimtarit e IT-së, telefonisë, arsimit, financave dhe të përfaqësuar:
 - 1.1. Periudha verore, prej orës: **08:00-23:00**;
 - 1.2. Periudha dimërore, prej orës: **08:00-21:00**;
 - 1.3. Festave zyrtare - sipas paragrafit 1.3 të nenit 4, nuk punohet..

Neni 15

1. Orari i punës në barnatore/farmacit:
 - 1.1. Periudha verore prej orës **8:00 – 22:00**;
 - 1.2. Periudha dimërore prej orës **8:00-22:00**;
2. Barnatoret ndahen në tre zona, Zona I – barnatoret që gjinden në afërsi të spitalit të qytetit, Zona II – barnatoret që gjinden brenda qytetit si dhe Zona III – barnatoret të cilat operojnë nëpër fshatrat e komunës.
 - 2.1. Orari i kujdestarisë të dielave dhe ditëve zyrtare është nga ora **8:00-22:00**;
(Kujdestarohet nga një barnatore për secilën Zonë I, II dhe III.)
 - 2.2. Orari i kujdestarisë së natës prej orës **22:00-08:00**;
(Kujdestarohet nga një barnatore në zonën I si dhe zonën II.)
 - 2.3. Orari i kujdestarisë do të përgatitet nga Barnatoret së bashku, i cili do të silllet në Drejtorinë e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale dhe në Drejtorinë e Planifikimit dhe Zhvillim Ekonomik, për miratim.

3. Ordinancat private mjekësore:

- 3.1. Klinikat Specialistike prej orës **10:00 - 20:00;**
- 3.2. Ordinancat Stomatologjike prej orës **10:00 - 20:00;**
- 3.3. Laboratorët dhe Rentgenët prej orës **07:00 - 19:00;**

4. Ordinancat veterinerë:

- 4.1. Periudha verore prej orës **7:00-24:00;**
- 4.2. Periudha dimërore prej orës **8:00-24:00;**
- 4.3. Në raste të nevojave emergjente lejohet puna më e gjatë se pika 1 dhe 2 e këtij paragrafi.

5. Festave zyrtare - sipas paragrafit 1.3 të nenit 4, nuk punohet, përjashtim bëjnë barnatoret/farmacitë që bëjnë kujdestari dhe ordinancat stomatologjike që mund të ofrojnë shërbime sipas nevojës.

Neni 16

Bizneset mund ta zgjasin orarin e punës me rastin e festave, të parapara me Ligjin për festat zyrtare, deri në orën 01:00 (të mëngjesit).

1. Për të gjitha rastet e parapara në pikën 1 të këtij neni, nuk paguhet taksa shtesë.

2. Zgjatja e orarit të punës:

4. Bizneset që dëshirojnë të punojnë më shumë se orari i përcaktuar me këtë rregullore, mund të parashirojnë kërkesë në Drejtorinë e Planifikimit dhe Zhvillimit Ekonomik e cila pas shqyrtimit, mund të lëshoj leje të posaçme për zgjatje të orarit, por jo më shumë se deri në ora **03:00**. Për çdo orë shtesë duhet të paguhet taksë prej **50:00 euro**. Meqenëse kjo mundësi u jepet bizneseve që për çfarëdo lloj nevojë apo situatë të punojnë më gjatë, biznesi duhet të ofroj dëshmi bindëse për orarin shtesë dhe këtë mund ta shfrytëzojnë deri në 3 (tre) herë gjatë vitit.

Neni 17

1. Bizneset prodhuese dhe ato përpunuese mund të punojnë sipas vëllimit dhe nevojave të tyre por duke respektuar standardet, sigurinë dhe qetësinë publike.

2. Bizneset që nuk janë të përfshira në dispozitat e kësaj Rregulloreje e propozojnë orarine punës të cilin në formë të shkruar me pëlqim e aprovon Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit Ekonomik.

Neni 18

Kryetari i Komunës mundet me vendim të posaçëm, kur e kërkon interesi publik të lejojë punën e bizneseve edhe në ditët e Festave zyrtare – sipas kësaj Rregulloreje.

III. DISPOZITAT NDËSHKUESE

Neni 19

1. Bizneset do të gjobiten për kundërvajtje, në qoftë se veprojnë në kundërshtim me nenet 5, 6, 7, 8, 9, 10, 11, 12,13,14,15,16,17, të kësaj Rregulloreje, si më poshtë:

- 1.1. Personat juridik200 – 400 €
1.2. Personat fizik 100 – 200 €

IV. DISPOZITAT KALIMTARE

Neni 20

Për zbatimin e kësaj Rregulloreje kujdeset Drejtoria e Inspeksionit dhe Drejtoritë tjera përkatëse të Komunës në bashkëpunim me Policinë e Kosovës dhe Gjykatën Kompetente.

Neni 21

Të gjitha bizneset janë të obliguara që të harmonizojnë orarin e tyre të punës me dispozitat e kësaj Rregulloreje, në afatin tridhjetë (30) ditësh nga dita e hyrjes në fuqi të kësaj Rregulloreje.

Secili biznes që eventualisht cakton ditë mos pune, atë duhet ta paraqes në orarin e punës.

Neni 22

Hyrja në fuqi

1. Kjo Rregullore hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të Ministrisë së Pushtetit Lokal si dhe 7 ditë pas publikimit në web faqen zyrtare të Komunës dhe në Gazetën Zyrtare, përkatësisht konform nenit 81 të ligjit për vetëqeverisje lokale nr.03/L-040, dhe nenit 9 paragrafi 8 të Rregullores (QRK) nr.10/2019 për shqyrtimin administrativ të akteve të komunave, me plotësim ndryshimet e bëre me Rregulloren nr.06/2021.

2. Me hyrjen në fuqi të kësaj Rregulloreje, shfuqizohet Rregullorja nr.01-311/05-0007450/20 e datës 31 janar 2020 për orarin e punës së bizneseve që operojnë në territorin e Komunës së Podujevës.

Nr.prot. 01-300/01-0084080/22
Podujevë, datë, 29.09.2022



Kryesuesi i Kuvendit
Elmi Hoxha